

KËRKIME GJUHËSORE

Miranda SHAHINI

Valter MEMISHA

DUKURI TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME NDAJSHTESA ME KUPTIM KEQËSUES NGA ANGLISHTJA NË SHQIP

Abstrakt. Përkthimi është veprimtari sfiduese dhe ka vështirësi disa prej të cilave shfaqen gjatë procesit të përkthimit pasi çdo gjuhë përshkruan botën në mënyra të ndryshme dhe ka strukturën e saj, rregulla gramatikore dhe ndryshime sintaksore. Gjatë këtij procesi, përballemi me problemet e dykuptimësisë, ndërtimet gramatikore me rregulla të vështira për t'u kuptuar. Problemet e gjuhës përfshijnë terma idiomatike dhe neologjizma si dhe zhargone të vështira. Problemet e tekstit burimor përfshijnë tekstin e palexueshëm si gërmëzimin e gabuar. Disa fjalë mbeten të papërkthyeshme kur dëshirojmë t'i ruajmë të njëjtën kategori gramatikore. Strukturat gramatikore komplekse duhen interpretuar në mënyrë korrekte në gjuhën e synuar. Një tjetër problem është kuptimi sidomos kur përkthejmë poezi, këngë etj. Problem tjetër është mungesa e një fjalori të pasur nga ana e përkthyesit. Në këtë punim do të trajtohen problemet e përkthimit duke u fokusuar në dukuri të përkthimit të fjalëve me ndajshtesa me kuptim negativ nga Anglishtja në Shqip.

Hyrje. Aktiviteti i përkthimit është praktikuar gjerësisht përgjatë historisë dhe roli i tij në botën tonë është bërë i një rëndësie të madhe. Sipas Edmond Tupes, teoricien përkthimi, "përsiatjet e para teorike mbi përkthimin i gjejmë në shekullin V tek Shen Jeronimi, por zhvillime të mirëfillta teorike gjejmë në shekullin e XVI tek Martin Luter "Qarkore mbi përkthimin" (E. Tupja, 2000 8-9) Në mijëvjeçarin e ri, në të cilin shkëmbimet kulturore janë duke u zgjeruar, njohuritë sa vijnë e zgjerohen dhe komunikimi ndërkombëtar intensifikohet, fenomeni i përkthimit është bërë themelor. Qoftë për qëllime shkencore, mjekësore, teknologjike, komerciale, ligjore, kulturore apo letrare, sot komunikimi njerëzor varet shumë nga përkthimi dhe, rrjedhimisht, interesi në këtë fushë është gjithashtu në rritje. Roli i përkthyesve dhe interpretëve në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ekonomisë, arteve, kinematografisë dhe këmbimit shkencor, është shumë i madh (P. Newmark, 1982).

Përveç përkthyesve të mirëfilltë apo të talentuar, ekzistojnë edhe dy kategori të tjera: nën-përkthyesit dhe pseudo-përkthyesit (E. Tupja, 2000). Të parët janë përgjegjës, modestë, punëtorë dhe mundohen të japin më të mirën, por nuk kanë talent dhe si rezultat përkthimet, interpretimet e tyre janë mediokre dhe kanë nevojë për ripërkthim nga një tjetër përkthyes, kështu lexuesi redaktor gjendet në pozicionin e bashkëpërkthyesit. I dyti i këtyre, pseudo-përkthyesi, është përshkruar më së miri nga Kokona, si individ i cili nuk ka as njohuri talent apo dëshirë për të punuar. Për fat të keq, kjo kategori e përkthyesve, si tregon ai, "është e angazhuar kryesisht në median e shkruar dhe elektronike, dhe madje edhe në përkthimet letrare" (E. Tupja 2000).

1. Procedurat e përkthimit, konceptet specifike ndërkulturore (KSN).

Përkthyesit jetojnë në një kufi, ku komunikimi gjuhësor komandohet me lehtësi relative, por ku depërtimi në kulturë mund të marrë një kohë më të gjatë për t'u arritur. Parashtrihen disa procedura të përkthimit KSN (Graedler (2000:3)):

1. *Trillimi i një fjalë të re.*
2. *Shpjegimi i kuptimit të shprehjeve të gjuhës burimore në vend të përkthimit të saj.*
3. *Ruajtja e termit të pacënuar në gjuhën burimore.*
4. *Zgjedhja e një fjale në gjuhën burimore që duket e ngjashme apo ka të njëjtën "lidhje" me termin e gjuhës së synuar*

Për përcaktimin e termave që bazohen në kulturë (TBK), të cilët i referohen koncepteve, institucioneve dhe personelit specifik të lidhur me kulturën e gjuhës burimore, parashtrihen katër teknika kryesore për përkthimin e TBK (Harvey, 2000):

1. *Ekuivalenca funksionale:* Do të thotë përdorimi i një referenti në kulturën e Gj.S. funksioni i të cilit është i ngjashëm me referentët në Gj.B. Sipas Harvey, autorët ndajnë mendime të ndryshme mbi këtë teknikë: (Weston, 1991) e përshkruan si "metoda ideale e përkthimit," ndërsa (Sarcevic, 1985:131) pohon se kjo është "çorientuese dhe duhet shmangur."
2. *Ekuivalenca formale ose linguistike:* Do të thotë përkthimi "fjalë për fjalë".
3. *Transkriptimi ose 'Huazimi'* (d.m.th. riprodhimi ose aty ku nevojitet, transliterimi i termit origjinal), i cili ndryshon nga strategjitë e drejtuara nga Gj.B. Nëse termi është formalisht transparent ose shpjegohet në kontekst, të mund të përdoret siç është. Në raste të tjera, veçanërisht kur supozohet se lexuesi i gjuhës së synuar nuk asnjë njohuri mbi gjuhën burimore, transkriptimi shoqërohet me një shpjegim në shënimet e përkthyesit.
4. *Përkthimi deskriptiv ose vetë-shpjegues:* Përdor terma të përgjithshme (jo TBK) për të transportuar kuptimin. Është i përshtatshëm për një shumëllojshmëri kontekstesh ku *Ekuivalenca Formale* konsiderohet pamjaftueshmërisht e qartë. Në një tekst që ka për qëllim lexuesin e specializuar, mund të jetë e dobishme të shtohet termi origjinal i gjuhës burimore për të shmangur dykuptimësinë.

Cilësia e përkthimit varet nga një numër faktorësh, disa prej të cilave, mund të jetë përtej kontrollit të hulumtuesit (Phillips, 1960:290). Në raste kur studiuesi dhe përkthyesi janë i njëjti person cilësia e përkthimit ndikohet nga faktorë të tillë si: Autobiografia e studiues-përkthyesit; njohuritë e hulumtuesit rreth gjuhës dhe kulturës së popullit nën studim (Vulliamy, 1990:166); dhe rrjedhshmërinë e studiuesit në gjuhën e shkruar. Kur studiuesi dhe përkthyesi nuk janë i njëjti person, cilësia e përkthimit ndikohet kryesisht nga tre faktorë: kompetenca, autobiografia dhe çka Temple (1997:610) quan "rrethanat materiale" të përkthyesit, që është pozicioni i mbajtur nga përkthyesi në lidhje me studiuesin. Përkthimi është një veprimtari sfiduese dhe ka vështirësi disa prej të cilave shfaqen gjatë procesit të përkthimit pasi çdo gjuhë përshkruan botën në mënyra të

DUKURI TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME NDAJSHTESA ME KUPTIM KEQËSUES NGA ANGLISHTJA NË SHQIP

ndryshme dhe ka strukturën e saj gramatikore, rregullat gramatikore e ndryshimet sintaksore. Problemet më specifike që hasin përkthyesit janë:

- *Problemet e dykuptimisë:* Këto burojnë nga dallimet strukturore dhe leksikore midis gjuhëve dhe njësive shumëfjalëshe si idiomat, foljet frazale etj..
- *Ndërtime gramatikore me rregullat e vështira për t'u kuptuar.*
- *Problemet e gjuhës:* Përfshijnë termat idiomatike dhe neologjizmat, zhargonet, probleme me rregullat e pikësimit, shkrimin e emrave të përveçëm të njerëzve, organizatave e vendeve.
- *Problemet e tekstit burimor:* Teksti i palexueshëm, gërmëzimi në mënyrë të gabuar. Mund të dallohet lehtësisht se gjuhët ndryshojnë nga njëra tjetra në disa drejtime e mënyra, jo vetëm gramatikisht. Për shembull, rrënjët e fjalëve janë të vështira për t'u përkthyer dhe kuptimi i fjalëve të zakonshme varet nga konteksti. Përveç kësaj, disa fjalë janë të papërkthyeshme kur dikush dëshiron të ruajë të njëjtën kategori gramatikore.
- *"Papërkthyeshmëria linguistike"* (fjalët e një burimi d.m.th. miqtë e vërtetë e të rremë, kalket, dhe forma të tjera të ndërhyrjeve; termat institucionale e të standartizuar, neologjizmat, aforizmat, etj.), dhe "papërkthyeshmëria kulturore," (idiomat, fjalët e urta, proverbat, shakatë, lojërat e fjalëve, etj.).

Sipas (P. Kussmaul, 1995), përkthyesi duhet të ndërmarrë një qëndrim shumë të matur përkundrejt këtyre fjalëve ose shprehjeve në mënyrë që të shmangë interferencën dhe/ose keqpërdorimin e gjuhës. Ekzistojnë qindra fjalë të cilat gjenden vetëm në Anglisht. Oxford English Dictionary liston rreth 250000 fjalë të veçanta, pa përfshirë terma teknikë ose zhargon, duke e bërë anglishten, një nga gjuhët më të pasura në fjalor: p.sh "pimp my ride", auto-tuned, trade off, spam, bromance, face palm, kitsch, googly goobledygook, serendipity etj..

Për papërkthyeshmërinë në dukje, e cila rezulton nga papajtueshmëritë strukturore ndërmjet gjuhëve, përkthyesi mund të përgjigjet me papërkthyeshmërinë potenciale, me mundësinë e shprehjes së koncepteve e përvojës njerëzore në çdo gjuhë njerëzore.

Një problem tjetër është se përkthyesit e gjejnë të vështirë të përcjellin të njëjtin kuptim në gjuhët e tjera, për shembull: Përkthimet e letërsisë, poezisë dhe këngët e kanë të pamundur të shprehin kuptimet e tyre të njëjta në një gjuhë tjetër. Kështu që këto tekste duhet të jenë të njohur në dy gjuhë, procesi i përkthimit nuk do të thotë vetëm përkthim fjalësh apo gjetje e rimës.

Gjithashtu duhet patur parasysh se mungesa e njohurive të fjalëve shkakton probleme të caktuara, prandaj përkthyesit duhet të kenë njohuri të thelluar të dy gjuhëve për të përkthyer tekste të avancuara dhe për të shmangur përdorimin e fjalorit që shpeshherë e bëjnë këtë proces shumë të mërzitshëm. Problemi i fundit është që përkthyesit do të hasin struktura gramatikore komplekse që duhen interpretuar saktë.

Sipas (Tancock 1958) është e qartë se deri diku konflikti midis përmbajtjes dhe formës (ose kuptimit dhe mënyrës) do të jetë akut, dhe se njëri apo tjetri duhet të tregohet. Në përgjithësi, përkthyesit janë dakord se, kur nuk ka

kompromis të lumtur, kuptimi duhet të ketë përparësi mbi stilin NIDA(1914–2011) në (L.Venuti).

2. Problemet fonologjike. Ky lloj është i kufizuar për disa lloje tekstesh, të tilla si tekstet letrare dhe reklamat. Shqetësimi kryesor i këtyre problemeve është tingulli dhe efekti i tij mbi kuptimin. Ky është përkthim i tingujve nga Gj.B. në Gj.S. për shkak të qëllimeve specifike. Në përkthimin e poezisë disa përkthyes përpiqen t'a bëjnë poemën e përkthyer si origjinali në aspektin e strukturës fonologjike duke gjetur tingujt në gjuhën e synuar, të ngjashëm me tingujt që përdoren në gjuhën burimore (Mahdi, 2007).

3. Problemet leksikore. Problemi në këtë nivel shfaqet kur përkthyesi nuk kupton një fjalë ose shprehje në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, apo nuk gjen ekuivalentin e saj në gjuhën synuar.

Ka disa tipa të këtij lloji të problemeve të tilla si: përkthim i fjalëpërfjalshëm, fjalët polisemike, monosemike, sinonimike, shprehjet frazeologjike, proverbat, metaforat, togfjalëshat emërorë, emrat e përveçëm organizmat politike, titujt, termat shkencore, akronimet si dhe kushtet gjeografike e teknike (Ghazala, 1995).

3.1 Problemet gramatikore. Një tjetër problem hasim kur fjalitë në kontekstin e grumbullimit të të dhënave përfshijnë struktura gramatikore dhe sintaksore që nuk ekzistojnë nga Gj.B. në Gj.S..

Stili sintaksor është një nga tiparet më të vështira për t'u zhvendosur nga njëra gjuhë në tjetrën Ercikan (1998:544). Aty ku fjalitë i rezistojnë përkthimit për shkak të mospërputhjes strukturore midis gjuhëve, kuptimi i fjalive “mund të përkthehet saktësisht në Anglisht (Bassnett-McGuire, 1980:32). Megjithatë, një proces i tillë, sipas në mënyrë të pashmangshme përfshin “prezantimin e pseudo informacionit ose humbjen e informacionit”. Gramatika është njësia qendrore e përpunimit të gjuhës, the organizëm i fuqishëm ku krijohen kuptimet (Ervin & Bower, 1952). Është e vështirë të konceptohet që sistemet nga cilat këto kuptime shprehen duhet të kenë evoluar përgjatë linjave shumë të ndryshme nga vetë gramatika (Halliday 1985/1994: 15).

Në këtë rast Anglishtja dhe Shqipja rrjedhin nga familje gjuhësore të ndryshme. E para gjuhë gjermanike perëndimore, e fundit një degë e veçantë indo-evropiane. Kjo rezulton në një hendek të gjerë midis gramatikave të tyre që shkakton probleme serioze për përkthyesit. Çdo gjuhë ka gramatikën apo strukturën e saj e cila dallon nga të tjerat, kjo çështje mund të paraqesë disa probleme në aspektin e gjetjes së një korrespondencë të drejtpërdrejtë në Gj.S. Dallime të tilla mund të shkaktojnë ndryshime të jashtëzakonshme në mënyrën sesi përcillet mesazhi. Këto ndryshime mund të detyrojnë përkthyesin të shtojë ose të heqë informacion në Gj.S. për shkak të mungesës së mjeteve të caktuara gramatikore në vetë Gj.S. Edhe numri koha, diateza, veta, gjinia etj., mund të shkaktojnë probleme në përkthim (Baker 1992). Ndryshimi Midis Gj.B dhe Gj.S. mund të çojë në shtimin e informacionit në Gj.S., i cili nuk shprehet në Gj.B. Lidhur me ndryshime gramatikore midis Shqipes dhe Anglishtes ato janë të shumta. Mund të përmendim sistemin e pyetjeve në Anglisht, i cili realizohet duke shtuar edhe foljen ndihmëse pa kuptim leksikor të mëvetësishëm në rastin kur bën

DUKURI TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME NDAJSHTESA ME KUPTIM
KEQËSUES NGA ANGLISHTJA NË SHQIP

pyetjen “do”, ndërsa pozicioni i parafjalës e cila në shqip është gjithmonë përpara, në Anglisht vendoset në fund të fjalisë.

Tab. 1. Pasqyron probleme të përkthimit në aspektin e sistemit gramatikor të Anglishtes kundrejt Shqipes

<i>Shprehja ne Anglisht</i>	<i>Përkthimi fjalë për fjalë</i>	<i>Përkthim përshtatës</i>	<i>Analiza dhe shpjegimi</i>
Where are you from?-	(Fjalë për fjalë) Ku je ti nga?-	Nga je?	
I love <u>reading</u> -		Më pëlqen shume leximi/të lexuarit.	“Leximi”, është emër, mund emërtojë edhe tekstin shkollor, ku zhvillohet lënda e letërsisë, ndërsa “të lexuarit” është emër foljor asnjans dhe shënon veprim.
I am <u>listening</u> to the radio-		Jam duke dëgjuar radion ose, po dëgjoj radion.	Në anglisht është kohë e tashme e vazhduar të foljes dëgjoj, ndërsa në shqip përkthehet me formën e pashtjelluar përcjellore ose me foljen “dëgjoj” të paraprirë nga pjesëza “po”.
<u>Wonderful</u> flowers-lule të <u>mrekullueshme</u>		<u>lule të</u> <u>mrekullueshme</u>	Po kështu edhe pozicioni i mbiemrave. Në Anglisht vendoset përpara emrit
<u>Dear Jane</u>		<u>E dashur Xhejn.</u>	Por kemi edhe forma të huazuara ku edhe në shqip vendoset mbiemri përpara zakonisht në fillim të letrave. Në fakt duhet të ishte gramatikisht korrekt në gjuhën Shqipe nëse do të shprehej <u>E dashura ime Xhejn.</u>

4.Problemet stilistike. Përkthyesit nuk tregojnë interes të veçantë mbi stilin, mjafton të shprehin idetë e origjinalit. Stili nuk është thjesht formë, por një mënyrë të qeni thelbësore për shkrimtarin që e dallon atë nga sivëllezërit e vet. Stili është pjesë kuptimit që mund të shkaktojë probleme për përkthyesit. Këto probleme mund të ndikojnë fuqishëm mbi kuptimin. Nëse nuk e marrim parasysh, ne kemi anashkalur një pjesë të kuptimit. Ndonjëherë përkthyesi gjen një lloj mosekuivalence në disa pika të tilla si formaliteti kundrejt informalitetit, stili i

thjeshtë kundrejt atij kompleks, fjalitë e shkurtra kundrejt fjalive të gjata, forma veprare kundrejt formës jo veprare dhe dykuptimësia. Kjo mosekuivalencë shkakton shumë probleme. Ambiguiteti rezulton nga përdorimi i një stili jo të mirë dhe ndonjëherë mund të përftojë kuptim të ndryshëm (E.Tupe, 2000). “Unë e shoh përkthimin si një përpjekje për të prodhuar një tekst aq transparent se ai nuk duket se është i përkthyer. Një përkthim i mirë është si një xham prej qelqi (Shapiro, 1986). Përkthyesit përballen me vështirësi gjatë përkthimit të gjuhës së synuar, sepse atyre u duhet të përdorin struktura, fjalë e mjete leksikore, rend fjalësh me të cilat ata nuk janë të njohur. Shkalla e formalitetit ose informalitetit është një problem që lidhet me fjalët dhe gramatikën. (Joos, 1962) sugjeron shkallët e formalitetit të gjuhës angleze që mund të interpretohen përmblendhësi si më poshtë.

Tab.2: *Shkallët që tregojnë dallimet midis Gj.B. e Gj.S. të cilat rezultojnë në probleme për lexuesit, që nuk janë në dijeni të këtyre formave.*

1 - Frozen formal (tepër formale)	1- “Be seated”(Uluni)
2 – formale konsultative (neutrale)	2- “Have a seat”(mund të uleni
3- informale (Jo formale) e shkujdesur	3- “Sit down, please” (të lutem, ulu
4 - e gjuhës së folur (bisedore)	4- “Feal at home” (rehatohu
5 - vulgare apo zhargon (vulgare OSE dialektike	5- “Sit bloody, down” (ulu, robo)

Vështirësia e përkthimit të poezisë është e dyfishtë: fjalët dhe kuptimi në njërin anë, fluksi dhe ritmi në anën tjetër. Përkthyesit duhet të jenë në gjendje të "lundrojnë në kuptimin historik dhe kulturor të fjalëve, problemet letrare apo estetike, strukturën poetike, shprehjet metaforike dhe tonin si dhe problemet socio-kulturore (Newmark 1988). Procedura e transferimit nuk mund të pohohet të jetë efektive ku konotacionet dhe kuptimet e nënkuptuara janë të rëndësishme. Janë disa emra në veprën *Gulestan* apo *Rose Garden* të poetit pers Sa'di, të cilët kanë ngjyresa tipike për kulturën e vendit të tij dhe kërkojnë një strategji specifike për t'u përkthyer. Zgjidhja mbi problemin e përmendur është si më poshtë: “fillimisht përkthehet fjala që shërben si bazë për emrin përveçëm të GJ. B në GJ. S., më pas përshtatet fjala në një emër të përveçëm të ri të SL” (Newmark-ut, 1988a:215). Megjithatë, ka një mangësi në strategjinë në fjalë. Siç duket kjo është e dobishme vetëm për emrat përveçëm, meqë duke mos marrë parasysh të drejtën e lexuesve të paarsimuar për të shijuar një tekst të përkthyer mund të përdoret vetëm “kur emri i personazhit është ende i panjohur për një lexues të arsimuar të GJ.S” (Newmark 1988a:215) **5. Probleme të përkthimi letrar.** Poezia është ajo që humbet në përkthim (Robert Frost 2008). Kjo do të thotë nuk ka ekuivalent një-për-një kur e krahasojmë poezinë në të dyja gjuhët. Edhe në qoftë se përkthyesit marrin një njohuri të thellë të gjuhës burimore, ata nuk do të jenë në gjendje të krijojnë

DUKURI TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME NDAJSHTESA ME KUPTIM KEQËSUES NGA ANGLISHTJA NË SHQIP

replikën e tekstit original. Njerëzit e një kulture të caktuar i shikojnë gjërat sipas perspektivës së tyre. Kultura të ndryshme janë me fokus të ndryshëm (Larson 1984). Disa shoqëri janë më shumë teknike dhe të tjera më pak teknike. Ky ndryshim pasqyrohet në sasinë e fjalorit e cila është e disponueshme të flasë për një temë të caktuar, nuk mund të jenë të dy së bashku edhe “fjalorin teknik dhe ai jo- teknik” i cili është i disponueshëm të flasë për të njëjtën gjë brenda një shoqërie të caktuar (Larson 1984:95).

6. Çështjet kulturore janë një tjetër problem. Problemet socio-kulturore ekzistojnë në frazat, togfjalëshat, ose fjalitë që përmbajnë fjalë të lidhura me katër kategoritë e mëdha kulturore, domethënë: ide, sjellje, produkt dhe ekologji (Said 1994:39). Gjatë përkthimit të shprehjeve lidhura me kulturën, përkthyesi mund të aplikojë një ose disa nga procedurat. Në përkthim letrar, një përkthyes përkthen njësi për njësi. Njësia e përkthimit mund të varrojë nga fjala në njësi më të mëdha të tilla si fraza ose togfjalëshi. Në procedurën e analizës komponenciale përkthyesi ndan një njësi leksikore në komponentët e tij kuptimorë, përkthimi shpesh një-me-dy, një-me-tre, apo më shumë. Për më tepër, një përkthyes nganjëherë shton disa informata, ose e vë atë në kllapa ose në fjalinë tjetër ose shkruan një fusnotë (poshtëshënim) ose fshin fjalë të parëndësishme të Gj.S. për t’a bërë më të thjeshtë rezultatin për lexuesit.

7. Problemet linguistike. Ato përfshijnë togfjalëshin dhe strukturën sintaksore të errët. Problemet estetike dhe letrare janë të lidhura me strukturën poetike, shprehjet metaforike dhe tonin. Përkthimi i veprave letrare është më i vështirë se përkthimi i llojeve të tjera të tekstit, sepse ata kanë vlera të veçanta estetike dhe ekspresive. Funkcioni estetik thekson bukurinë e fjalëve (diksioni), gjuhën figurative, metaforat, etj.

Ndërsa funksionet ekspresive parashtrojnë mendimin e shkrimtarit (ose procesin e të menduarit), emocionin, etj, në një poemë, bukuria nuk arrihet vetëm me zgjedhjen e fjalëve dhe gjuhën figurative, si në romanet dhe tregimet e shkurtra, por edhe me krijimin i ritmit, rimës, metrit, dhe shprehjeve e strukturave të veçanta që nuk mund të përputhen me ato të gjuhës së përditshme.

8. Dukuri të përkthimit të fjalëve me ndajshtesa me kuptim keqësues nga Anglishtja në shqip. Për të ilustruar probleme të përkthimit të fjalëve me ndajshtesa me kuptim negativ nga Anglishtja në Shqip kemi trajtuar çdo fjalë me ndajshtese negative nga vepra e William Shakespeare “Hamleti” e përkthyer nga Fan Noli, nga ku kemi përzgjedhur disa shembuj specifike duke dhënë edhe shpjegimet përkatëse.

MIRANDA SHAHINI & VALTER MEMISHA

Nr f.	Në Gjuhën Angleze	Në Gjuhën Shqipe	Shpjegimi
f. 6	some strange eruption	krismë të papritur	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të PËRKTHIMIT TË FJALËPËRFJALSHËM. Mbiemrit “Strange” në ANGLISHT i përgjigjet mbiemri i njëzuar dhe i parashtesuar negativisht “të papritur” në Shqip.
Faqe 6	compulsatory	me pahir (unwillingly)	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të PËRKTHIMIT TË FJALËPËRFJALSHËM. Ndajfoljes “compulsatory” në ANGLISHT i përgjigjet ndajfolja parashtesuar negativisht “unimproved” në Shqip.
f.7	The graves stood tenantless	nga varret duallet të vdekurit	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të MODULIMIT duke ndryshuar këndvështrimin e së njëjtes dukuri jashtëgjyhesore realizuar në rrafshin e përmbajtjes. Mbiemri në Anglisht “tenantless” është përkthyer me fjale të tjera.
f. 8	For it is, as the air, invulnerable (e paprekshme)	se është er e s’mundim t’a qellojmë.	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të MODULIMIT duke ndryshuar këndvështrimin e së njëjtes dukuri jashtëgjyhesore realizuar në rrafshin e përmbajtjes. Mbiemri në Anglisht “invulnerable” është përkthyer në rang fjalie jo fjale.
f. 9	Impotent	pa fuqi	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të ZHVENDOSJES. Kuptimi është dhënë i saktë, por mbiemrit “impotent” në Anglisht, i përgjigjet emri “pa fuqi”.
f. 11	Of impious stubbornness; 'tis unmanly grief; It shows a will most incorrect to heaven; A heart unfortified, a mind impatient; An understanding simple and unschool'd; For what we know must be, and is as common As any the most vulgar thing to sense,	Me një vajtim pa funt nuk tregon Veç kokëngjeshje; te pafeshme, çnjerëzore Zemër të paforcuar; mendje të egër, kuptim të paarrirë e të papjekur	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të MODULIMIT duke ndryshuar këndvështrimin e së njëjtes dukuri jashtëgjyhesore realizuar në rrafshin e përmbajtjes. Në të gjitha fjalët në Anglisht të shprehura me parshesë negative, nuk gjejmë një ekuivalent kuptimor një për një në shqip. Kuptimi është përkthyer saktësisht por në rang vargu, jo fjale, apo fjalie. Edhe në Shqip është shprehur e njëjta gjë me më pak fjali, gati gjysma e atyre në Anglisht. Në Anglisht janë 7 rreshta, në Shqip vetëm katër të tilla.
f. 22	infinite	të pakufishme,	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të PËRKTHIMIT TË FJALËPËRFJALSHËM. Si në Anglisht ashtu edhe në Shqip na paraqitet parashtesë me kuptim negativ + mbiemër. Kuptimi i parme është “i, e papërcaktuar” por edhe “të pakufishme” përbën një sinonim.
f. 27	Unhous'led, disappointed, unanel'd	pa myrë, pa pendim e pa kungatë,	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të ZHVENDOSJES duke ndryshuar pjesën e ligjeratës. Në Anglisht mbiemrat janë të parashtesuar negativisht, në Shqip emra me pjesëz mohuese.
f. 65	Mischance	mërzi	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të PËRKTHIMIT TË FJALËPËRFJALSHËM. Emrit “Mischance” në Anglisht i përgjigjet në Shqip emri “mërzi”.
f. 88	Makes mouths at the invisible event; Exposing what is mortal and unsure	të rri të pakten prej frikaci s’ di. Pse rroj akoma e them” Kjo duhet bërë	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës përkthimore të MODULIMIT duke ndryshuar këndvështrimin e së njëjtes dukuri jashtëgjyhesore realizuar në rrafshin e përmbajtjes. Mbiemrat e prapashësuar negativisht në Anglisht “invisible, e unsure” janë përkthyer në Shqip me fjale të tjera.
f.	That carry but half sense:	flet gjëra e errata pa kuptim, fjalë	Është dhënë në Gjuhën Shqipe me anë të metodës

DUKURI TË PËRKTHIMIT TË FJALËVE ME NDAJSHTESA ME KUPTIM
KEQËSUES NGA ANGLISHTJA NË SHQIP

89	her speech is nothing. Yet the <u>unshaped</u> use of it doth move	të palidhura,	përkthimore të MODULIMIT duke ndryshuar këndvështrimin e së njëjtës dukuri jashtëgjuhësore realizuar në rrafshin e përmbajtjes. Mbiemri i prapashësuar negativisht në Anglisht “ <u>unshaped</u> ” është përkthyer në Shqip me fjalë të tjera. Në Shqip kemi një mbiemër të parashësuar negativisht por edhe ky nuk i përgjigjet mbiemrit “Unshaped”.
----	--	---------------	---

9.Konkluzionet

Përkthimi i fjalëve me ndajshtesa me kuptim keqësues si çdo përkthim nga Anglishtja në Shqip përballet me probleme të natyrave të ndryshme. Në veprën “Hamleti” Noli ka marrë në konsideratë kuptimin i cili është thelbi i çdo përkthimi, dhe jo fjalët të izoluara. Kështu, është fokusuar në karakteristikat e të dyja gjuhëve për të transmetuar mesazhin saktësisht dhe për të përfutur një tekst të synuar të ngjashëm me origjinalin. Roli i përkthyesve është të mos e lënë audiencën e synuar të mendojnë se teksti të cilin ata po lexojnë është përkthim, por tekst origjinal, gjë që Noli e ka realizuar në mënyrën më të mirë të mundshme si edhe në shume raste me të njëjtat mjete gramatikore. Në të gjithë shembujt pa përjashtim mesazhi është transmetuar i qartë dhe në shumicën e tyre është dhënë me ndajshtesisht negativ në të dyja gjuhët. Në raste të rralla kemi edhe përkthime me antonime, apo humbje të fjalëve, ndoshta jo me shumë potenciale stilistike, kuptimi i pastër, mesazhi i qartë.

BIBLIOGRAFI

- P. Newmark, (1982) *Approaches to Translation*, Oxford/ New York/- Toronto: Pergamon Press, f. 10-14 & f. 65.
- E. Tupja, (2003) *PRO TRANSLATORE*, Shtjellime Kritike për Përkthyesin dhe Përkthimin Tiranë: OMBRA OVG. p. 61, 62).
- [A.L. Graedler, (2000). Cultural shock. Retrieved December 6, 2006 from <http://www.hf.uio.no/iba/nettkurs/translation/grammar/top7culture.html>].
- [Harvey, M. (2003). A beginner's course in legal translation: the case of culture-bound terms. Retrieved April 3, 2007 from <http://www.tradulex.org/Actes2000/harvey.pdf>].
- S.Sarcevic,(1985): Translation of culture bound terms in law. *Multilingua*, No. 4:3, 127-133.
- M.Weston, (1991) *An english reader's guide to the French legal system*, New York/Oxford, Berg. f. 23.
- H. P. Phillips, (1960) Problems of translation and meaning in field work. In R. N. Adams and J. J. Preiss (eds) *Human Organisation Research: Field Relations and Techniques*. Homewood, ILL:
- G. Vulliamy, (1990:166) Research Outcomes: PostScript. In G. Vulliamy, K. Lewin and D. Stephens, *Doing Educational Research in Developing Countries*, London, The Falmer Press.
- B. Temple, (1997:610) Watch your tongue: issues in translation and cross-cultural research. *Sociology*, 31(3), 607-618.
- P.Kussmaul, 1995 Training the translator, Benjamin translation library, f 16. <http://listverse.com/2011/07/13/10-hard-to-translate-english-words>.

MIRANDA SHAHINI & VALTER MEMISHA

- R. de Pedro, (1999: 547): "The translation of texts: a historical overview," *Meta* 44-4, f. 547-559.
- L. V. Tancock, Some problems of style Translation from French, Smith 1958:f 29-51.
- E. NIDA, (1914–2011) Principles of correspondence f 4 in: Laurence Venuti (ed.), *The Translation Studies Reader*. London. New York: Routledge.
- A.A. Mahdi, (2007) *A Dictionary of Translation and Interpreting*. Oman, Ithra Li Al-Nashr WaAl-Tawzia.
- H.(Ghazala, 1995).Translation as problems and solutions. Lybia: ELGA .
- K. Ercikan, (1998) Translation Effects in International Assessments. *International Journal of Educational Research*, 29, f 543-553.
- S. Bassnett-McGuire, (1980:32) *Translation Studies*. London: Methuen.
- S. Ervin, and R. T. Bower, (1952) f 597-598, Translation Problems in International Surveys. *Public Opinion Quarterly*, 16, f 595-604.
- M.A.K. Halliday, (1985/1994) *An Introduction to Functional Grammar*, 2nd Edition, London: Arnold.
- M. Baker, In *Other Words. A Course Book on Translation*. Routledge. London.
- E. Tupe, Këshilla një përkthyesi të ri, Shtëpia Botuese Onufri, Rr."S. Pasha" Tiranë 2000 (f 60).
- D. Kratz, (1986)"An Interview With Norman Shapiro", *Translation Review* 19:27-28. cituar ne L.Venuti, *The Translator's Invisibility. A History of Translation*. London and New York, Routledge, coll. «Translation Studies», 1995, 353 pages.
- M. Joos, (1962). *The Five Clocks*. *International Journal of American Linguistics*, 28, 2 pts.
- P. Newmark, 1988. *Textbook of Translation*. Oxford: Pergamon Press.
- P. Newmark, 1981. *Approaches to Translation*. Oxford: Pergamon Press.
- L. Larson, Mildred, (1984) *Meaning-Based Translation: A Guide to Cross-Language Equivalence*. Lanham and New York: University Press of America, Inc. f. 95-96 .
- M. Said, 1994. *Socio-cultural Problems in the Translation of Indonesian Poems into English, (A Case Study on "On Foreign Shores")*. Unpublished Thesis. IKIPMalang.
<http://www.translationdirectory.com/article640.htm>
- W. Shakespeare, *Hamlet* the Folger Shakespeare library. Washington Square press 1230 avenue of the americas new york NY 10020. 1992.
- W.Shakespeare. *Hamleti, shqipëroi Fan Stylian Noli*, Tiranë 1953
Bp. Bruxelles, 1996.